

REPUBLIKA E SERBISE
 KA E KOSOVES DHE METOHISE
 PROKURORIA PUBLIKE E QARKUT
 PP.nr.322/98
 Peje, me 22.02.1999.

GJ Y K A T E S - S E Q A R K U T

P E J E

Ne baze te nenit 45 al.2 pika 3,dhe nenit 174 al.2 LPP,
 ngrise:

A K T A K U Z E

Kunder:

1. LAN MATAJ,nga f.Baballoq,Komuna e Deçanit,i lindur me 1951,i biri i Haxhiut dhe Nulijes e gjinise Gjocaj,Shqiptar,shtatas i RFJ, me pare i denuar,gjindet ne paraburgim ne burgun e Qarkut ne Peje,prej dt. 18.12.1998,

2. BRAHE BEQIRAJ,nga f.Baballoq,Komuna e Deçanit,i lindur me 1966,i biri i Aliut dhe i Mires e gjinise Salihu,Shqiptar,shtetas i RFJ me pare i denuar,gjindet ne paraburgim ne burgun e Qarkut ne Peje,prej dt. 18.12.1998.

PER SHKAK SE:

Me qellim te rrezikimit te rregullimit kushtetutar dhe te sgurise se RFJ,jane bere pjesetare te personave te bashkuar me qellim te kryerjes se vepres penale te terorizmit nga neni 125 te LP RFJ,ne ate menyre qe ne muajin qershori te vitit 1998,ne f.Baballoq,Komuna e Deçanit, i jane qas GDT te organizes teroriste te ashtuquajt "UÇK",e cila nga pozicionet e separatizmit shqiptar kryen sulme te armatosura ndaj pjesetareve te MPB te RS,pjesetareve te ushtrise jugosllave,qytetareve te nacionilitet serbe dhe malazias dhe objekteve te tyre,dhe pjesetareve te pakices kombetare shqiptare,te cilet tregojne lojalitet ndaj RS dhe RFJ, dhe kryejne akte tjera te dhunes,me qfar krijohet ndjenja e pasigurise se qytetareve,ashtu qe si pjesetare i asaj organizate:

- I pand. Lan Mataj,eshte ngarkuar me njé pushke automatike, me 150 fyshek dhe ka kryer detyren e kujdestarise ne shtabin e GDT dhe ka bere roje,me detyrim,poqese do te vijne pjesetaret e MPB te RS,ne t'a te hapi zjar,

- I pand.Brahe Beqiraj,eshte ngarkuar me arme dhe municion me te cilat ka kujdestaruar ne shtabin e GDT dhe ka bere roje,me detyre,po qese do te vijne pjesetaret e MPB te RS,ne t'a te hapi zjar,

- me çka secili nga te pandehurit veq e veq kane kryer vepër penale te bashkimit per veprintari armiqsore nga neni 136 al.2 lidhur me al.1,e lidhur me nenen 125 te LP RFJ.

A n d a j,

P R O P O Z O J M E

Ne ate gjykate si kompetente vendore dhe lendore, te caktohet shqyrtimi kryesor ne te cilin te ftohen:

- Prokurori publik i Qarkut ne Peje,
- Te pandehurit nepermjet te drejtorise se burgut te

Qarkut ne Peje.

Ne shqyrtimin kryesor si prova te nxirren dhe te lexohen:

- Listat mbi orarin e rojeve dhe te kujdestarise.

Ekstrakti nga evidenca kriminalistike per te pandehurit.

A r s y e t i m

Gjate hetuesise eshte vertetuar se ne f.Baballoq,Komuna e Deçanit,ne muajin maj te vitit 1998,eshte formuar GDT te organizates teroriste te ashtuquajtur "UÇK",e cila nga pozicioni i separatizmit shqiptar tenton qe me sulme te armatosura te krijoj kushtet per shkeputje me dhune te Kosoves dhe Metohise nga RFJ.

Metutje eshte vertetuar se i pand.Lan Mataj,ne muajin qershor te vitit 1998,eshte bere pjesetar i asaj organizate,se eshte ngarkuar me nje pushke automatike me 150 fyshek,me te cilen ka bere roje dhe kujdestari ne shtabin e GDT ne fshat.

Per te pand.Brahe Beqiraj,eshte vertetuar se ne muajin qershor te vitit 1998,eshte bere pjesetare i organizates se permendur teroriste,se ka kujdestarue ne shtabin e GDT dhe ka bere roje,edhe gjere ne kohen kur eshte thyer GDT ne ate teritor,pas qfar eshte mshehur ne f.Piskote, Komuna e Gjakoves.

Gjendja e pershkruar faktike eshte vertetuar nga mbrojtja e te pandehureve dhe nga listat mbi kujdestarite dhe rojet,te cilat jane zene me rastin e thyerjes se GDT ne f.Baballoq,origjinalet e te cilave gjinden ne shkresat e lendet se prokurorise PPN.nr.73/98.

I pan.Lan Mataj,ne mbrojtjen e vet nuk konteston se ne muajin qershor te vitit 1998,eshte ngarkuar me nje pushke automatike me 150 fyshek dhe se nje muaj e gjysem ka kujdestaruar ne shtabin e GDT,dy here ne jave.Thekson se nuk i perket organizates teroriste dhe se armen nuk e ka qite jashte shtabit dhe se me arme nuk ka bere roje ne fshat.

Nga listat e kujdestarise,del se i pandehuri ne priudhen kohore prej 19.-30.06.1998,ka patur tri kujdestari ne shtab dhe se me 20.06.1998,ka bere roje.Nga listat tjera mund te shifet se diten e paver- tetuar eshte ngarkuar me 150 fyshek dhe se me daten 14.07.1998,ne emer te asaj çka i takon ka marre nje pako duhan.

Nga kjo gjendje faktike gjejme se nuk mund te aprovohet mbrojtja e te pandehurit Lan Mataj,se nuk ka qene pjesetar i organizates teroriste,nga se me vet ngarkesen me arme dhe municion dhe ne kryerjen e detyres se kujdestarise ne shtab te GDT,ka manifestuar pjesemarrjen e vet ne ate organizate.

3.-

I pand.Brahe Beqiraj ne mbrojtjen e vet thekson se nuk a qene pjesetar i "UÇK" dhe se nuk ka dashur te ngarkohet me arme dhe nacion,per qfar ka qene i ftuar ne shtab te GDT qe te deklarohet.Ne shtab ka qene i detyruar te ziej kafe, dhe te ndihmoj "rreth njefar pregetitjeje". Se ne f.Baballoq ka qendruar 3 muaj dhe se gjate asaj kohe ka patur shtierje nga armet,por se ai nuk ka vepruar,nga se nuk ka patur arme.


Gjejme se nuk mund te aprovohet mbrojtja e te pand.Brahe Beqiraj,se nuk ka qene pjesetar i organizates teroriste dhe se nuk ka patur arme,nga se nga listat e orarit te rojeve shifet se ka qene i caktuar per e bere roje me 18.dhe 27.06.1998,e detyra e rojes pa arme nuk ka mundur te kryhet.

Kur kesaj i shtohet edhe e dhena e cila rrjedhe nga vet mbrojtja e tij,se ne shtabin e GDT ka zier kafe dhe ka punuar ne"njefar pregetitjeje",per kete me siguri mund te mirret se ka qene pjesetar i organizates se permendor.

Pasi qe eshte vertetuar se te pandehurit jane bere pjesetar te personave te bashkuar te formuar me qellim te kryerjes se vepres peale te terorizmit,per kete gjejme se kane kryer veper penale te bashkimit per veprimitari armiqsore nga neni 136 al.2 lidhur me al.1,e lidhur me nenin 125 te LP RFJ.

Pasi qe nuk ka rrethana,te cilat kishin me perjashtuar pergjegjesine penale te te pandehureve,gjejme se aktakuza eshte e arsyeshme dhe ne ligj e bazuar.

PROKURORI PUBLIK,
Milladin Popoviç,d.v.

Perktheu,

M. Popović